



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 506

NR. VENDIMI 2897

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqësore Lusjana Fezollari, sot më datë 23. 04. 2019 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me Nr. 5743/1013/506 Regj. Themeltar që i përket :

PADITES: SHOQERIA ***, ***, e perfaqesuar me prokure te posaçme dt. 22. 09. 2016 nga av. ***.

I PADITUR: SHOQERIA ***, (ne mungese).

PERSON I TRETE: DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE, me adrese Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona Nr. 33, Shtepia e Ushtarakeve (ne mungese).

OBJEKT: 1. Shfuqizimi i regjistrimit ne Shqiperi te markes “***” regjistruar nga i padituri me numer regjistrimi nderkombetar Nr. ***.
2. Detyrimi i DPPI te ç’regjistroje ne Shqiperi marken “***”, regjistruar nga i padituri me numer regjistrimi nderkombetar ***.

BAZA LIGJORE: Nenet 31 e vijues, 153 e vijues dhe 334-348 te K.Pr.Civile; Neni 638 e vijues i K.Civil; Neni 173, 143 (1) dhe (2.b) i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Per Pronesine Industriale”

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesuesit te pales paditese, i cili kerkoi: Pranimin e kerkese-padise si te bazuar ne ligj dhe ne prova, si shqyrtoi ne teresi ne mungese te te paditurit dhe personit te trete ne mungese te te paditurit dhe te personit te trete ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor,
VEREN :

Se, paditësi *** eshte subjekt tregtar me seli ne *** dhe e regjistruar ne regjistrin tregtar mbajtur nga Gjykata Rajonale e *** dhe ne kerkese padine drejtuar Gjykates ka kerkuar sic eshte percaktuar ne objektin e padise.

Gjykata, pasi studioi materialet e çështjes civile te paraqitur per gjykim, ne baze te nenit 36 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: “Ne juridiksionin e Gjykatave hyjne te gjitha mosmarreveshjet civile dhe mosmarreveshje te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te veçanta”, duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreveshje me karakter civilo-tregtarv qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese, cmoi kryesisht se ceshtja e paraqitur eshte ne juridiksionin

gjqesor.

Persa i perket kompetences lendore, mbeshtetur ne nenin 41 te K.Pr.Civile ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Ne kompetence te Gjykates se Shkalles se Pare jane te gjitha mosmarreshjet civile e mosmarreshjet e tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te tjera", duke qene se ceshtja e paraqitur per shqyrtim eshte nje mosmarreshje civile, eshte kompetente nga pikepamja lendore per shqyrtimin e kesaj ceshtjeje.

Lidhur me kompetencen tokesore, ne baze te nenit 42 te K.Pr.Civile i cili parashikon se: "Padite ngrihen ne Gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqendrimin e tij dhe kur keto nuk dihen, ne Gjykatën e vendit ku ai ka banesen e perkohshme" por edhe të nenit 43 të K.Pr.Civile i cili parashikon se "Kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në Gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij". Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile percakton se : «Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod".

Sa me siper, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane per shqyrtimin e kesaj ceshtjeje objekt konflikti.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32/a te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi ne baze te se ciles do te perfitoje te drejta personale - pasurore.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Paditesi ka si objekt te aktiviteti te tij tregtar prodhimin dhe tregtimin e birres "****" ne territorin e Republikes se Shqipërisë.

Nga gjykimi siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit te markave leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale qe prej vitit 1970 paditesi ka regjistruar ne Shqiperi marken "****", me Nr. regjistrimi ***. Afati i regjistrimit eshte ripërterire disa here. Afati ne fuqi ka qene ne fakt deri me vitin 2020 nderkohe qe kerkese-padia eshte regjistruar ne gjykate ne dt. 11. 01. 2017. Klasat per te cilat kjo marke eshte regjistruar sipas Klasifikimit Nderkombetar te Marreshjes se Nices jane Nr. 31 dhe 32, per produktet Birre, Malto.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi gjithashtu se nga ekstrakti i regjistrimit te markave leshuar nga Personi i trete, i padituri Shogeria ***, me date 30. 09. 2004 ka kryer nje regjistrim nderkombetar ne baze te Marreshjes se Madridit, per marken "****" me Nr. regjistrimi Nr. ***. Afati i regjistrimit ka qene deri me date 30. 09. 2014. Klasa per te cilat kjo marke eshte regjistruar sipas Klasifikimit Nderkombetar te Marreshjes se Nices eshte ajo Nr. 32, per produktin Birre.

Perfaqesuesi i paditesit si ne shpjegimet ne gjykim ashtu edhe ne pretendimet perfundimtare sqaroi se ne vitin 2007, pala e paditur shogeria *** i eshte drejtuar Gjykates ne rolin e paditesit me objekt te kerkese-padise shfuqizimin e markes tregtare te regjistruar nga paditesi *** me pretendimin se ky i fundit nuk e kish perdorur ate (nepermjet tregtimit dhe importimit) ne tregun shqiptar per me shume se 3 (tre) vjet me rradhe.

Siç rezulton nga vendimi gjyqesor Nr. *** dt ***, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur: rrezimin e kerkese-padise, vendim i cili ka marre forme te prere, pasi

Gjykata e Apelit Tirane me vendimin Nr. ***, date ***, ka vendosur: lenien ne fuqi te vendimit te sipercituar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Po keshtu midis ketyre paleve ka patur perseri nje mosmarreveshje tjeter gjyqesore ne lidhje me te drejten e perdorimit si marke ne Republiken e Shqiperise te fjales “****”.

Konkretisht kjo mosmarreveshje eshte bere perseri konflikt gjyqesor ku me vendimin Nr. *** dt. *** te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur: “Pranimin e kerkese padise. Shfuqizimin ne Shqiperi te markes “****” regjistruar nga i padituri me Nr. regjistrimi nderkombetar me Nr. *** dhe ndalimi i tregtimit te produkteve te te paditurit me marken “****” ne tregun shqiptar”.

Me vendimin Nr. *** vendimi dt. *** Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur “Lenien ne fuqi te vendimit Nr. *** dt. *** te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane”. Pas kesaj ky vendim eshte vene ne ekzekutim prane personit te trete, duke u urdheruar DPPI te beje ç’regjistrimin ne Shqiperi te Markes Nr. *** ne emer te te paditurit. Nga ana e DPPI eshte bere nje cregjistrim i tille, gje per te cilen eshte njoftuar dhe paditesi.

Rezulton se kohe me vone paditesi ka marre dijeni perseri se pavaresisht vendimit te mesiperm gjyqesor te formes se prere, i padituri ka aplikuar perseri per shtrirjen ne Shqiperi te nje marke tjeter me emrin *** me Nr. nderkombetar ***, per te njejtat klasa per te cilat marka e meparshme e saj ishte shfuqizuar.

Duke gene se edhe kjo marke e te paditurit ashtu sikunder marka tashme e ç’regjistruar Nr. *** permban fjalen *** dhe i referohet klasave te njeita, ky regjistrim i ri cenon te drejtat e meparshme te paditesit, vertetuar me vendimin e formes se prere te sipercituar.

Rrjedhimisht per te mbrojtur te drejtat e tij te cilat shkelen rishtazi nga i padituri, paditesi i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese-padi duke kerkuar shfuqizimin e markes se regjistruar nga pala e paditur me Nr. nderkombetar ***.

Gjykimi per palen e paditur u zhvillua ne mungese te tij pasiqe edhe pse u njoftua rregullisht me ane te leterporosise nepemjet Ministrise se Drejtesise ne referim te Nenit 219 te K. Pr. Civile dhe Konventes se Hages “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” te vitit 1965, edhe pse mori dijeni efektive, pa asnje shkak ligjor nuk u paraqit ne gjykim duke vleresuar ne kete menyre gjykata qendrimin e kesaj pale ne harmoni me shpjegimet e pales paditese dhe provat e administruara ne gjykim.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palës paditëse, çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dipozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndrvshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Nisur nga keto parime proceduriale, rezulton per gjykaten se sipas vendimit Nr. *** dt. *** te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me vendimin Nr. *** dt. *** te

Gjykates se Apelit Tirane, eshte arsvetuar se:

...Gjykata pas analizes se provave ne gjykim vlereson se kerkese padia e ngritur prej paditesit eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

Keshu nga gjykimi rezultoi e provuar se paditesi ka regjistruar ne Shqiperi marken "****", me Nr. regjistrimi *** ne vitin 1970 fakt ky i konfirmuar nga ekstrakti i regjistrit te markave leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave. Afati i regjistrimit eshte ripertesore disa here. Afati ne fuqi ka gene ne fakt deri me date 07.01.2010 nderkohe qe kerkese padia eshte regjistruar ne Gjykate ne dt. 16.11.2009.

Klasat per te cilat kjo marke eshte regjistruar sipas Klasifikimit Nderkombetar te Marreveshjes se Nices jane Nr. 31 dhe 32, per produktet Birre, Malto.

Ne fakt nga gjykimi rezultoi gjithashtu se nga ekstrakti i regjistrit te markave leshuar nga personi i trete, i padituri Shoqeria ***, me date 30.09.2004 ka kryer nje regjistrim nderkombetar ne baze te Marreveshjes se Madridit, per marken "****" me Nr. regjistrimi Nr. *** me afat regjistrimi deri me date 30.09.2014. Klasat per te cilat kjo marke eshte regjistruar sipas Klasifikimit Nderkombetar te Marreveshjes se Nices eshte Nr. 32, per produktin Birre.

Gjykata konstatoi ne gjykim se pala e paditur, shoqeria ***i eshte drejtuar Gjykates me padi ne pozicionin procedural te paditesit me objekt kerkese padie shfuqizimin e markes tregtare te regjistruar nga paditesi *** me pretendimin se ky i fundit nuk e kish perdorur ate (nepermjet tregtimit dhe importimit) ne tregun shqiptar per me shume se 3 (tre) vjet me adhe. Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr. *** dt. ***, ka vendosur rrezimin e kerkese padise, vendim i cili ka marre forme te prere, pasi Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin Nr. ***, date ***, vendosi lenien ne fuqi te vendimit te sipercituar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizes se ekstrakteve te regjistrimit prane personit te trete, konstaton se si marka e paditesit ashtu edhe ajo e te paditurit permbajne fjalen identike "****" dhe vlereson qe kjo perputhje mund te sjelle nje coroditje te konsumatorit, fakt i cili perforcohet ende me teper nese shikohet qe produktet per te cilat markat jane regjistruar jane identike pra - Birre - Klasa 32.

Gjykata gjithashtu konstaton se ne procesin gjyqesor te zhvilluar midis paleve dhe te cituar me siper pala e paditur *** ka kerkuar shfuqizimin e markes se paditesit, (***) vec te tjerash edhe per faktin se midis markave te regjistruara prej tyre ka ngjashmeri te atille sa qe mund te sjelle ngaterrim te konsumatorit mesatar.

Gjykata ne analize te dispozitave te cilat sherbejne si baze ligjore per padine ne gjykim e konkretisht te neneve 76, 143 (1), (2b) dhe 173 (1) te Ligjit Nr. 9947 date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", ne te cilet eshte parashikuar qe: "Nje shenje nuk mbrohet si marke, ne qofte se, perdorimi i saj si marke bie ne kundersiztim me te drejtat e meparshme. Ne menyre te vecante si te drejta te meparshme konsiderohen: (a) nje marke identike ose e ngjashme e nje pale te trete, ne lidhje me mallra ose sherbime identike ose te ngjashme" por edhe "Gjykata, me kerkese te personit te interesuar, shfuqizon marken e regjistruar, kur ajo ne kohen kur eshte depozituar aplikimi per regjistrim nuk i permbush kerkesat e neneve 142 e 143 te ketij Ligji" si edhe "Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundersiztim me te drejtat e meparshme. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur: b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme" konstaton qe kerkese padia e ngritur prej paditesit *** eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te pranohet.

Gjykata arrin ne kete perfundim pasi u provua plotesisht ne gjykim qe se pari paditesi *** e ka te regjistruar marken e tij prane Drejtorise se Patentave dhe Markave me pare se i padituri e konkretisht ne vitin 1970, fakt ky i provuar plotesisht ne gjykim dhe se dyti markat jane te ngjashme dhe ofrojne sherbime te ngjashme ç'ka e konfuzon publikun.

Ne lidhje me pretendimet e perfaqesuesit te te paditurit ne gjykim Gjykata i vlereson ato te pabazuara ne ligj per arsyet e pershkuara me siper.

Nga sa siper Gjykata duke e çmuar kerkese padine te bazuar ne ligj e konkretisht ne dispozitat te cilat kane sherbyer si baze ligjore per padine por edhe ne prova e konkretisht ne ato te shqyrtuara e administruara ne gjykim vlereson ta pranoje ate duke vendosur shfuqizimin ne Shqiperi te markes “***” regjistruar nga i padituri me Nr. regjistrimi nderkombetar me Nr. *** dhe ndalimi i tregtimit te produkteve te te paditurit me marken “***” ne tregun shqiptar.

Marre shkas nga ky vendim i siperpermendur, gjykata në çeshtjen objekt shqyrtimi vlerëson se, në nenin 451/a të K. Pr. Civile parashikohet shprehimisht se: “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për ç’ka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton se gjëja e gjykuar në procesin civil shfaqet në 2 (dy) aspekte, në atë formale dhe në atë substanciale (materiale).

a) Në kuptimin formal ajo shfaqet s’i një gjendje juridike e ezaurimit të mjeteve procedurale të ankimit, s’i dhe e ekzistencës së prekluzivitetit lidhur me mundësinë për t’u ankuar ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë.

b) Në kuptimin substancial (material) ajo kuptohet s’i një gjendje juridike jo thjesht pamundësie nga palët ndërgjyqëse të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për të rihapur shqyrtimin e çështjes, por edhe si një e drejtë e secilës prej tyre për të kundërshtuar mundësinë e rishikimit të zgjidhjes së dhënë për konfliktin në një gjykim të ri.

Në interpretim dhe zbatim të nenit 451/a të K. Pr. Civile, vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjidhur çështjen në themel, përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes s’i në kuptimin konstituiv, ashtu dhe atë prekluziv.

Në kuptimin konstituiv, ai jep zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitave të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohe mundësia e kërimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. E thënë ndryshe autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimi i procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t’i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe të vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi (res iudicata est).

Në kuptimin objektiv, gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me të njëjtin objekt të padisë dhe të njëjtin shkak ligjor (causa petendi) të saj, ndërsa në kuptimin subjektiv gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me faktin që ajo që është vënë në bisedim (kërkimet, pretendimet, prapsimet), sipas parimit të kontradiktorialitetit dhe që është vendosur në gjykim me anë të urdhërimeve të vendimit, është e detyrueshme vetëm ndërmjet palëve

ndërgjyqëse në gjykim, trashëgimtarët e tyre dhe personat që tërheqin të drejta nga palët, fakt ky i cili të shpie në përfundimin se arsyeja, mjete juridik nëpërmjet të cilit ligji mbështet dhe përcakton pakundërshtueshmërinë e asaj që vërtetohet dhe disponohet me vendimin e formës së prerë, është efekti prekluziv, ndalues për ringritjen dhe përsëritjen e parashtrimit në gjykatë të kërtimeve dhe prapsimeve të bëra apo që mund e duhet të ishin bërë rreth mosmarrëveshjes gjatë gjykimit, dhe për të cilat gjykata përfundimisht ka vendosur në zbatim të vullnetit të ligjit.

Fuqia e “gjësë së gjykuar” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në gjykim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron gjykata në dispozitivin e vendimit të saj.

Nëse në një gjykim të ardhshëm shtrohen për diskutim e shqyrtim çështje të provës apo të së drejtës që kanë lidhje thelbësore me çështjet për të cilat është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë, pra me çështje që ka çmuar, pranuar dhe urdhëruar gjykata në atë vendim, edhe kur aty ka palë ndërgjyqësa, objekt e shkak ligjor të ndryshëm nga ai i vendimit gjyqësor që ka marrë formë të prerë, apo edhe nëse në dukje mund të parashtrihen s’i kërtime për herë të parë, atëherë ndalohet vënia në bisedim dhe shqyrtimi gjyqësor i këtyre çështjeve, për arsye se në procesin civil, “gjëja e gjykuar” mbulon jo vetëm kërkimet, por edhe prapsimet e parashtruara, apo që mund dhe duhet të ishin parashtruar për të kundërshtuar faktet konstituive të së drejtës së pretenduar në gjykim nga ana e paditësit apo e kundërpaditësit.

Fakti i sipërcituar të shpie në përfundimin se autoriteti e fuqia e “gjësë së gjykuar” mbulon jo vetëm kërkimet e prapsimet e bëra gjatë gjykimit (gjëja e gjykuar e shprehur), por edhe ato që mund dhe duhet të bëheshin me anë të ngritjes së padisë, kundërpadisë apo prapsimeve, të cilat ndonëse të patrajtuara në vendimin e formës së prerë prezumohen se bëjnë pjesë në mënyrë të pashmangshme në llogjikën juridike të arsyetimit, të përfundimeve dhe urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë (të njohur si gjëja e gjykuar e heshtur, e nënkuptuar).

Në rastin konkret, rezulton se natyra e kërimit të parashtruar nga paditesi në kërkesë-padine e paraqitur prej tij për shqyrtim të jetë e njëjtë me natyrën e kërimit të parashtruar në gjykimin e çështjes së gjykuar me vendimin gjyqësor Nr. *** dt. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lene ne fuqi me vendimin Nr. *** dt. *** te Gjykates se Apelit Tirane. Konkretisht nga cilësimi i fakteve dhe pretendimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi duke i krahasuar ato me pretendimet e parashtruara në çështjen e gjykuar me vendimin gjyqësor të sipërcituar rezulton se pretendimet e paditesit në këtë gjykim shtrihen ndaj te njejtave kerkimeve qe lidhen me ndalimin e konkuresces se pandershme, ç’regjistrimin e markes ne emer te te paditurit, etj, po keshtu shkak ligjor i ketyre kerkimeve eshte teresisht i njejte.

Nisur nga keto rrethana gjykata per keto kerkime ne ate gjykim, eshte shprehur se: Gjykata arrin ne kete perfundim pasi u provua plotesisht ne gjykim qe se pari paditesi *** e ka te regjistruar marken e tij prane Drejtorise se Patentave dhe Markave me pare se i padituri e konkretisht ne vitin 1970, fakt ky i provuar plotesisht ne gjykim dhe se dyti markat jane te ngjashme dhe ofrojne sherbime te ngjashme ç’ka e konfuzon publikun.

Fakti i sipërcituar të shpie në përfundimin se në thelb çështja objekt gjykimi përbën “gjë të gjykuar”, pasi të gjitha pretendimet e pales paditese, rezulton të jenë shqyrtuar më parë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me vendimin e saj Nr. *** dt. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lene ne fuqi me vendimin

Nr. *** dt. *** te Gjykates se Apelit Tirane rezulton t'i ketë gjetur këto pretendime të bazuara dhe të provuara duke e pranuar për këtë qëllim kërkesë – padinë e paraqitur nga ana e paditësit në atë gjykim.

Perpos kesaj vleresohet se paditesi aktual ka qene mbajtes i se drejtes se pronesise se markes tregtare “****” marke e mirenjohur nderkombetarisht, e cila nga ana e saj, jo vetem qe ka bere regjistrimin e kesaj marke qe ne vitin 1970, por eshte sjelle si mbajtese dhe pronare e saj per gjithe kete kohe ne territorin Shqiptar.

Si te tilla (faktet) gjykata e ka legjitimuar kete shoqeri (paditesin) ne ceshtjen e siperpermendur dhe ka marre ne shqyrtim pretendimet e saj ne themel duke u shprehur per to.

Fakti i reregjistrimit tashme nga i padituri te se njeites marke nga ana e tij por me numer tjeter nderkombetar (***) por qe permban fjalen ***, per paditesin aktual nuk prezumon edhe dhenien e se drejtes pales paditese te ringreje perseri te njeita pretendime te shqyrtuara njehere si te tilla dhe qe lidhen me marken e saj. Kjo pasi marka ne emer te paditesit ne vetvete me te gjitha treguesit e saj te mbroitjes eshte trajtuar ekskluzivisht ne procesin gjyqesor dhe per gjykaten ne kete proces merret si e mireqene.

Fakti i ekzistences tashme te reregjistrimit te ri te markes ne emer te te paditurit, jo vetem qe nuk e ben ate si nje marke te krijuar rishtazi, por nuk passjell dhe asnje lloj indicje qe te mund te merret ne rishqyrtim marka si e tille. Kjo pasi nje gje e tille jo vetem qe do te shkaktonte nje pasiguri juridike per çdo subjekt tregtar qe do mund te preket nga nje veprim i tille, por do te krijonte nje konfuzion ne kete fushe dhe do perbente premise per ngritjen e padise nga mbajtesi i saj ne çdo kohe qe pala e paditur do te abuzonte me regjistrime te njepasneshme mbi marken e mbroitur tashme ne emer te paditesit.

Ne kete proces gjykata mjaftohet me faktin se e njeita pale ndergjyqese ka regjistruar nje marke tjeter qe permban perseri emrin *** dhe qe produktet per te cilat kjo marke eshte regjistruar jane identike “Birre-Klasa 32” me marken e regjistruar me pare ne emer te paditesit.

Ndodhur ne keto kushte gjykata vlereson se vetem per kete shkak (gje e gjykuar) pa patur atributin per te rigjykuar edhe njehere themelesine e pretendimeve te pales paditese lidhur me kerkimet e saj per konkurencen e pandershme, c’regjistrimin e markes tregtare etj, cmon se padia duhet pranuar si e tille.

Per gjykaten shkak i padise eshte teresisht i qarte pasi midis markave te regjistruara nga palet ndergjyqese ka ngjashmeri te atille qe krijon konfuzion tek konsumatori mesatar dhe se marka e paditesit eshte regjistruar kohe me pare prane personit te trete sesa marka e te paditurit.

Neni 173 (1) i Ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Per pronesine industriale” percakton se: “Gjykata me kerkesen e personit te interesuar, shfuqizon marken e regjistruar, kur ajo ne kohen kur eshte depozituar aplikimi per regjistrim nuk i permbush kerkesat e Neneve 142 e 143 te ketij ligji”.

Neni 143 (1), (2b) i Ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Per pronesine industriale” percakton se: “Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundershtrim me te drejtat e meparshme. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur: b) eshte e njeite ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e

bashkelidhjes me marken e meparshme”.

Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Gjykata, bazuar në Nenet 126, 306-308 e vijues të K. Pr. Civile,

VENDOSI :

Pranimin e kërkesë-padisë.

Shfuqizimin e regjistrimit ne Shqiperi te markes tregtare “*”, regjistruar nga i padituri me numer regjistrimi nderkombetar Nr. ***, si dhe ç’regjistrimin nga ana e Drejtorise se Pronesise Industriale te kesaj marke ne Shqiperi.**

Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e shpalljes se tij per palen prezent dhe nga e nesermja e dites se komunikimit te vendimit per palet ne mungese.

U shpall sot me dt 23. 04. 2019, ne Tirane.

SEKRETARE

GJYQATAR

LUSJANA FEZOLLARI

ERVIN POLLOZHANI

Shpenzimet gjyqësore

Taksë padie 3 000 lekë

Shpenzime njoftimi llog gjykates 1 900 lekë

Totali

4 900 lekë